



Prokuroria jep detaje për vrasjen në Prizren, kuksianët u qëlluan me armë nga “Kobra” derisa po largoheshin me veturë

KRONIKA | January 03, 2023 - 14:53
SHËPËRNDAJE: [Facebook icon] [Twitter icon]

Detaje të reja janë mësuar për rastin që ka ndodhur mëngjesin e sotëm në Prizren, ku një 31-vjeçar është vrarë dhe një tjetër është plagosur.



This site

Kryeprokurori Admir Shala ka folur për rastin, ku ka thënë se ngjarja tragjike dyshohet se ka ndodhur pas një konflikti në lokalin "Kobra City", i cili është pronë e Dibran Hoxhës, që dyshohet se ka shtënë me armë në drejtim të dy personave derisa po largoheshin me veturën e tyre.


Motivet e konfliktit dyshohet se ishte pagesa e faturës së shërbimeve, transmeton Zeri.info.

"Sot në orën 04:10, policia ka marrë informatë se ka pasur të shtëna në afërsi të lokalit 'Kobra City', në dalje të Prizrenit rruga Prizren-Kukës. Dyshohet se ngjarja tragjike ka ndodhur pas një konflikti në lokalin 'Kobra City' me disa shtetas të Shqipërisë, lidhur me pagesën e faturës së shërbimeve".

"Në momentin që shtetasit V.C., R.Sh. dhe A.B. po largoheshin me automjetin e tyre të markës 'Audi', dyshohet se shtetasi D. H. ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të automjetit të tyre. Si pasojë e të shtënave me armë zjarri 31-vjeçari me inicialet V. C. dhe R. Sh., 27 vjeç, të dy nga Kukësi janë plagosur, ku si pasojë e plagëve shtetasi V.C. ka vdekur, ndërsa shtetasi R.Sh. ka pësuar lëndime trupore dhe është jashtë rrezikut për jetë", ka thënë kryeprokurori Shala.

Ai shtoi se Prokuroria Themelore në Prizren së bashku me Policinë e Kosovës janë duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, me qëllim të sigurimit të provave dhe zbardhjes së rrethanave të ngjarjes.

"Organet e zbatimit të ligjit të Kosovës dhe ato të Shqipërisë janë në bashkëpunim për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes. I dyshuari D.H. dyshohet për veprën penale "Vrasje e rëndë", shtoi Shala. /Zëri




Shikoni sa mund t'ju kushtojnë implantet dentare të gjithë gojës në Vlorë

Implantet Dentare | Kërko reklama | Sponsored



Veturat e pashitura në Vlorë po shkojnë për qindarka në dollar

Ofertat e makinave | Kërko reklama | Sponsored



Ish-ushtari i UÇK-së u vra sot në Pejë nga djali i axhës, shkak mosmarrëveshja për një pronë

Një vrasje ka ndodhur gjatë ditës së sotme në Novosellë të Pejës, ku i vrarë ka mbetur Bashkim Brahimaj, ish-ushtar i UÇK-së. Gazetari Florent Zeqaj ka dhënë detaje nga kjo...

Zeri.info



Marrja e një pune anësore mund të jetë më e lehtë nga sa e kishit menduar - edhe online

Punë nga Shërbija | Kërko reklama | Sponsored



Shtëpitë e të Moshuarve të saponërtuara me jetesë të pavarur - ia vlen t'i hidhni nj...

Jetessa e të Moshuarit | Kërko reklama | Sponsored



Albania:The Cost Of Solar Panels May Surprise You(See Prices)

Best Solar Panel System | Sponsored



Ky është 'spiuni' shqiptar që u arrestua nga BIA në Serbi

Detajet


Zeri.info



Villas Prices In Dubai Might Be More Affordable Than You Think.

Villas in Dubai | Search | Sponsored

Të rekomanduara



Ky është personi që u gjet i vdekur në...

January 03, 2023

Vrasja në "Kobra City", axha i viktimës: Nipi u qëllua brenda veturës nga prapa [video]


KRONIKA | January 03, 2023

Aksidenti në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, katër të lënduar

KRONIKA | January 03, 2023

Arrestohet i burgosuri që u arratis derisa po transportohej për në Gjykatë

KRONIKA | January 03, 2023



Flet avokati i "Kobrés", i dyshuar për...

January 03, 2023

I plagosur në konfliktin e ndodhur në Prizren, 27-vjeçari nga Kukësi dërgohet për trajtim në Tiranë

KRONIKA | January 03, 2023

IPK-ja rekomandon suspendimin e një zyrtari policor, dyshohet për kanosje

KRONIKA | January 03, 2023

Prokuroria jep detaje për vrasjen në Prizren, kuksianët u qëlluan me armë nga "Kobra" derisa po largoheshin me veturë

KRONIKA | January 03, 2023


Më të lexuarat



Dibran Hoxha, i njohur si "Kobra", dyshohet se vrau 31-vjeçarin mbrëmë në Prizren



Fatura 400-euroshe dyshohet të jetë motivi i vrasjes së mbrëmshme në Prizren




Arrestohen Dibran Hoxha dhe pesë të tjerë pas vrasjes së mbrëmshme



Babai nga Peja raporton vdekjen e djalit të tij, Policia nis hetimet



Publikohet fotografia e të riut që u vra mbrëmë në Prizren



Iu anulua fluturimi, kosovari sulmon policin në aeroportin e Prishtinës